



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTORI

Nr. 885 Prot.

Tiranë, më 16.10.2023

URDHËR
Nr. 92, DATË 16/10/2023

MBI

“FILLIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR STUDENTËT TË CILËT DO TË APLIKOJNË PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 1 dhe 5 të ligjit nr. 10289, datë 17.06.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik dhe financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetërorë dhe të Policisë së Burgjeve që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, në nenin 2 të ligjit Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e invalidit”, i ndryshuar, VKM Nr. 869, datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit Nr. 7889, datë 14.12.1994 Për Statusin e invalidit”, i ndryshuar, në nenin 6 të ligjit Nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, i ndryshuar, nenin 8 të ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, nenin 8 të ligjit Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invlaidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar, nenin 12 të ligjit Nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist”, i ndryshuar, nenin 32 të ligjit Nr/ 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar), dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e pranimit të aplikimeve, nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët përfitojnë bursë, për vitin akademik 2023-2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Ngritjen e grupit të punës që do të merret me administrimin e procesit në çdo Fakultet. Personat përgjegjës sipas fakulteteve janë si më poshtë:
 - Nermin ZEBI (Fakulteti i Muzikës) – nermin_zebi@yahoo.com;
 - Arta DASHI (Fakulteti i Arteve të Bukura) – arta_dash@yahoo.com;
 - Enela MASTORI (Fakulteti i Artit Skenik) – enelamastori@yahoo.com
3. Studentët duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit si dhe dokumentacionin provues fizikisht dhe në adresën elektronike të personave të përcaktuar në pikën 2.
4. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, (formulari bashkëngjitur), publikuar në faqen WEB të UART.
5. Personat përgjegjës, i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrtojnë dokumentacionin e paraqitur nga studentët, përcaktojnë studentët që përfitojnë ose jo bursë për vitin akademik 2023-2024.
6. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit nga studentët është data 16.11.2023.
7. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit në zyrën e protokollit në Rektorat nga grupi i punës është data 23.11.2023.
8. Në vijim të procedurës, dokumentacioni i kalohet Sektorit Juridik për verifikim.
9. Pas verifikimit të dokumentacionit të Grupit të Punës nga Sektori Juridik, përgatitet informacioni për Administratoren e Universitetit të Arteve.
10. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare WEB të Universitetit të Arteve dhe të afishohet në ambientet e Fakulteteve të UART.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Dekanët, zyra e Protokollit të UART, personat përgjegjës në çdo Fakultet si dhe sekretaritë e fakulteteve dhe sektori i IT për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot ÇAUŠHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE